

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Asim Vokshi te Naureda Llagami/ Të gjitha fijet që të çojnë te Erion Veliaj
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/nga-asim-vokshi-te-naureda-llagami-te-gjitha-fijet-qe-te-cojne-te-eri-i474925
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:08:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 16:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	15c49a100e3beec314d39bc48aeded7b6933dc6afad9f907cf7d8163bf5852a1
TEKSTI	9014998f9b973d14bc36d4ace564138d0c2693022687010a543f8b0654f2fc0a
PAMJA	1cdcec755aec7f62d6d262943cd47116c5f9407dcff0f247647e39b28972a9b5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	181b815974cf2beb03b4f5de00c88d728dfaa351632a7880d484a16c98a10f3d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/181b815974cf2beb03b4f5de00c88d728dfaa351632a7880d484a16c98a10f3d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)




English
English

Nga Asim Vokshi te Naureda Llagami/ Të gjitha fijet që të çojnë te Erion Veliaj



22 Shtator 2026, 18:28, Aktualitet CNA



Ka histori që në pamje të parë duken si episode të ndara, por kur i vendos njëra pas tjetrës, fillojnë të tregojnë një ngjarje krejt tjetër. Historia e Asim Vokshit, Naureda Llagamit, Ajola Xoxës, Klotilda Bushkës dhe Vlora Hysenit është një prej tyre. **Në qendër është Gjykata Kushtetuese, por fijet shkojnë shumë më larg se një garë për një vend vakant.**

Asim Vokshi, gjyqtar që njihet për integritet të lartë, ishte një kandidat që kishte kaluar vettingun dhe ishte konfirmuar në detyrë nga KPK. Më pas, në garën për Gjykatën Kushtetuese, ai u rendit i pari nga KED, me Naureda Llagamin menjëherë pas tij. Dhe pikërisht në këtë proces doli në skenë një informacion i rëndë për Vokshin, informacion që e paraqiste si bashkëpunëtor, informator apo agjent të shërbimeve të inteligjencës.



Taktika e avokatëve të Veliajt, si "forum shopping"

Ky informacion nuk është një detaj i parëndësishëm. Ai kishte potencialin të godiste drejtpërdrejt kandidaturën e Asim Vokshit në garën për Gjykatën Kushtetuese. Gjyqtari e ka mohuar një akuzë të tillë, ndërsa edhe mënyra se si informacioni u administrua dhe u përdor në mënyrë aq të dyshimtë është bërë objekt debati publik.

Por ajo që e bën historinë shumë më interesante është se përballë Asim Vokshit ishte Naureda Llagami. Asnjëherë gjyqtare.

Por Naureda Llagami nuk ishte një emër i shkëputur nga ky rreth. Marrëdhënia e saj me Ajola Xoxën dhe Klotilda Bushkën është e njohur dhe nuk del thjesht nga ndonjë njohje protokollare. Komunikimet dhe takimet e bëra publike provojnë një marrëdhënie të afërt shoqërore mes tyre. Lidhja me Ajola Xoxën është edhe më konkrete, pasi Naureda Llagami kishte punuar në studion e saj ligjore. Këtu nuk kemi thjesht tre gra që janë takuar rastësisht në ndonjë aktivitet publik, por një rreth marrëdhëniesh personale dhe profesionale të konsoliduara dhe dokumentuara në publik.



Lëmshi i Sokol Sadushit me mandatet e kupolës së sistemit të drejtësisë

Kjo është arsyeja pse edhe roli i Klotilda Bushkës nuk mund të shkëputet nga historia. Raportimet për komunikimet mes saj, Ajola Xoxës dhe Naureda Llagamit kanë nxjerrë në dritë një afërsi që shkon përtej marrëdhënies institucionale. Pikërisht këto marrëdhënie lidhen në raportimet publike me ngjytjen e Llagamit në KLGJ dhe më pas me garën për Gjykatën Kushtetuese.

Pra, kemi një vijë që është e vështirë të mos vihet re. Naureda Llagami, Ajola Xoxa, Klotilda Bushka. Nga marrëdhëniet personale te institucionet, pra nga KLGJ te Kushtetuesja.

Më pas del gjyqtari Asim Vokshi. Një kandidat i konfirmuar nga vettingu, me integritet të padiskutueshëm, i renditur i pari nga KED dhe rival i drejtpërdrejtë i Naureda Llagamit, ndaj të cilit shfaqet pabaritur nga hici. Një informacion nga strukturat e sigurisë që e vendos në pikëpyetje figurën e tij.



Si e fshehu Sokol Sadushi dosjen, KED mori informacion se Asim Vokshi ishte informator ose agjent i shërbimeve sekrete

Nëse ky informacion është përcjellë nga SHISH-i, atëherë emri i Vlora Hysenit nuk mund të lihet jashtë kësaj historie. Në atë kohë ajo drejtonte shërbimin inteligjent shqiptar. Nëse, siç është raportuar, informacioni ndaj Asim Vokshit ka dalë nga SHISH-i, atëherë fakti që ai informacion godiste pikërisht rivalin e Naureda Llagamit merr një peshë të jashtëzakonshme.

Nuk është e nevojshme të përsëritet këtu njëqind herë se kush mori 89.5 dhe kush 89.3 pikë. Ajo është pjesa teknike e historisë. Pjesa politike është tjetër. Njëra kandidate kishte marrëdhënie të afërta me Ajola Xoxën dhe Klotilda Bushkën, kishte punuar në studion e Xoxës dhe po ngjitej në institucionet e drejtësisë. Përballë saj ishte një kandidat tjetër, gjyqtar karriere ndaj të cilit papritur serviret një informacion i rëndë nga strukturat e sigurisë.

Pas kësaj situate pyetja është kush i shërbeu kujt bëhet imperative.

Nëse Vlora Hyseni, përmes SHISH-it që drejtonte, ka përcjellë informacion kundër Asim Vokshit në një moment kur ky i fundit ishte rivali i drejtpërdrejtë i Naureda Llagamit, atëherë ky nuk është më një episod administrativ, por një veprim që objektivist i shërben kandidaturës përballë tij. Nëse në anën tjetër të kësaj historie qëndrojnë marrëdhëniet e afërta të Naureda Llagamit me Ajola Xoxën dhe Klotilda Bushkën, atëherë lidhja bëhet edhe më e fortë si çështje që kërkon shpjegim.

Sot Vlora Hyseni është vetë nën një masë sigurie dhe e pezulluar nga drejtimi i SHISH-it në kuadër të një hetimi tjetër. Kjo nuk lidhet me çështjen e Asim Vokshit, por e bën edhe më të rëndësishme pyetjen se çfarë ka ndodhur realisht me informacionin që doli kundër tij dhe kush e ka përcjellë atë.



Prapaskenat/ Vlora Hyseni, nga shkarkimi tek Inteligjenca e Kosovës, te ardhja në krye të SHISH-it

Kjo histori nuk ka të bëjë më me një garë për një vend në Kushtetuese, por me mënyrën se si marrëdhëniet personale, pushteti politik dhe institucionet e drejtësisë mund të kryqëzohen në një moment vendimtar.



Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni; Harta e një shteti që po shpërbëhet

Nga Asim Vokshi te Naureda Llagami. Nga Naureda Llagami te Ajola Xoxa dhe Klotilda Bushka. Nga aty te institucionet. Dhe në mes, një informacion i shërbimit inteligjent të Vlora Hysenit kundër kandidatit rival.

Kjo nuk ishte një seri rastësish, por një zinxhir marrëdhëniesh, ndërhyrjesh dhe interesash që synonte të ndikonte mbi garën për Gjykatën Kushtetuese. Dhe kur fijet e këtij zinxhiri ndiqen deri në fund, ato të çojnë te i njëjti rreth pushteti, te Ajola Xoxa dhe, pas saj, te Erion Veliaj.

Ishte dhe është një përpjekje për të kapur edhe Gjykatën Kushtetuese./CNA

CNA

01:12 | 25 shtator



CNA.AL

SHANTAZHI I HYSENIT NDAJ KLODIANA LALËS

Asociacioni i Gazetarëve dënon sulmin ndaj gazetares

sport

Stërvitja e personalizuar me ndihmën e inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave pritet të përmirësojë performancën



U PARAQIT NË GJKKO

12:05 ▼

Ish-kryetarja e SHISH, Vlora Hyseni, fyen gazetaren: S'kam lënë takime me agjentët serbë në dhomat e hotelit siç ke lënë ti

MOTI SOT

DIBËR: 10° / 17°



Të sugjeruara

Kur Berat Buzhala del si budalla

GJKKO revokon sekuestron e pasurive të ish-gjyqtarit

Edi Rama mund ta turpërojë edhe më shumë Shqipërinë

Gazetari: Vlorë Hyseni e ka mbyllur ciklin e karrierës, sinops për dokumentar

Industria e gjobëvënies/ Nikolin Jaka: Bizneset përballen me humbje serioze financiare

Mbledhja e FBINAA-së/ Ambasada e SHBA-së: Qëllimi i vetëm është zbatimi i fortë i ligjit

Sekuestrohet hoteli 5-katësh pa leje në Ksamil, 1 shtetas në arrest shtëpie

Sulmet e mediave anonime/ Dhoma e Tregtisë: Të zbatohen masat që mbrojnë biznesin

Masa e sigurisë për Vlorë Hysenin/ Rama e liron nga detyra si kryetare e SHISH

[Gjobëvënia nga mediat dhe portalet anonime/ Nikolin Jaka: Po sulmohen dhe dëmtohen qëllimisht bizneset](#)

[Projektligji i ri krijon hapësirën e posaçme ligjore për emetimin e obligacioneve të mbuluara](#)

[Kikia: Ngjarje fatale, zyrtarët e inkriminuar kanë ngrënë kokën e shtetit](#)

[Masa ndaj Hysenit/ Xhafaj, si Spiropali: Ndodh rëndom në botë](#)

[Operacioni i SPAK-ut/ Kontrolle në kompleksin e vilave në Shkozë](#)

[Vlora Hyseni dhe Ilir Proda në rrjetën e SPAK-ut/ Prokuroria e Posaçme jep detaje](#)

[Apeli i Posaçëm lë në burg Ergys Agasin dhe ish-efektivin që e shoqëronte](#)

["Rama e Agasi takoheshin në Durrës"/ Kush është Embro Sulejmani?](#)

[Vlora Hyseni drekonte e darkonte me Agasin në mes të Tiranës](#)

[Prapaskenat/ Vlora Hyseni, nga shkarkimi tek Inteligjenca e Kosovës, te ardhja në krye të SHISH-it](#)

[Opozita "bllokoni" Komisionin/ Përplasje pas aksioneve të SPAK-ut](#)

[editorial](#)

16:30 Editorial

[Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni: Harta e një shteti që po shpërbëhet](#)

CNA LIVESTREAM



01:12 | 25 shtator



CNA.AL

SHANTAZHI I HYSENIT NDAJ KLODIANA LALËS
Asociacioni i Gazetarëve dënon sulmin ndaj gazetares

sport

Stërvitja e personalizuar me ndihmën e inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave pritet të përmirësojë performancën



U PARAQIT NË GJKKO

12:05 ▼

Ish-kryetarja e SHISH, Vlora Hyseni, fyen gazetaren: S'kam lënë takime me agjentët serbë në dhomat e hotelit siç ke lënë ti

MOTI SOT

DIBËR: 10° / 17°

Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

odinion

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.